



Udhëzues miqësor për fëmijë

*Parandalimi dhe raportimi i
dhunës në shkollë
dhe jashtë saj*

Ky udhëzues është financuar nga Qeveria Suedeze me mbështetje të Save the Children. Përgjegjësia për përmbajtjen qëndron tek QKSGJ. Qeveria Suedeze apo Save the Children jo domosdoshmërisht i ndan pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

PËRMBAJTJA

Qëllimi i udhëzuesit	6
Cili ligj të mbron nga dhuna?	7
Parandalimi i dhunës	7
Cilat janë të drejtat e tua në shkollë?	9
Kush të mbron nëse përjeton dhunë brenda dhe jashtë shkollës?	10
Në shkollë	10
Institucionet tjera	11
Çka nëse dhuna ndodh në shtëpi apo mjedise jashtë shkollës?	14
Si të identifikosh dhunën?	14
Pse është e rëndësishme të raportosh?	18
Çfarë ndodh pasi të raportoj?	18
Si mund të ndihmosh më tutje?	19
a. Angazhohu në këshillin e shkollës	19
b. Respekto barazinë gjinore	19
c. Merr pjesë në aktivitetet e organizuara nga shkolla	20
d. Bisedoje me shokët dhe shoqët e tua!	20
Shtojcë. Aktivitet individual	21

Mesazh për ty

I/E dashur Nxënës/e,

Ky udhëzues është dizajnuar për ty, që të të
ndihmojë të njohësh disa nga format e dhunës në
shkollë dhe jashtë saj dhe çfarë të bësh nëse diçka
të ndodh ty apo shokëve dhe shoqëve tua.

Mbaje në mend: dhuna nuk arsyetohet në asnjë
rrethanë, andaj, ti ke të drejtë të ndihesh i/e sigurtë
brenda dhe jashtë shkollës.

Shpresojmë se ky udhëzues do të jetë i dobishëm
për ty dhe fëmijët e tjerë.

MIRËNJOHJE

Ky udhëzues është hartuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), botuar në kuadër të projektit “Përfshirja e fëmijëve si qytetarë aktivë në promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe perspektivës gjinore” në partneritet me Save the Children Kosovo/a dhe financohet nga Agjensia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar. Qëllimi i këtij projekti është adresimi i të drejtave të fëmijëve nga perspektiva gjinore, si dhe forcimi i kapaciteteve dhe zgjerimi i ekspertizës së organizatave të përfshira në projekt në mënyrë që ato të marrin rolin e tyre mbikëqyrës dhe avokues në avancimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Autore: Sabina Kaqinari, Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Të drejtat autoriale

© Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), 2025. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet ose futet në një sistem rikthimi ose të transmetohet në çfarëdo forme ose me çfarëdo mënyre, elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese ose ndryshe, pa lejen paraprake të QKSGJ-së.

QËLLIMI I UDHËZUESIT

Qëllimi i këtij udhëzuesi miqësor është të të ndihmojë ty dhe fëmijët e tjerë që të kuptojnë se çfarë është dhuna, si ta identifikojnë atë, dhe më e rëndësishmja ku ta raportojnë në mënyrë të sigurt brenda dhe jashtë shkollës. Ky udhëzues synon të:

- Nxisë ndërgjegjësimin për të drejtat e tua dhe rëndësinë e një mjedisi të sigurt shkollor.
- Ofrojë udhëzime të thjeshta dhe të kuptueshme për format e dhunës dhe mënyrat e raportimit të dhunës;
- Shpjegojë hapat që ndodhin pas raportimit, që të kesh siguri dhe besim në proces;
- Forcojë rolin tënd si nxënës dhe pjesëmarrës aktivë në krijimin e një ambienti të sigurt, përfshirës dhe pa dhunë në shkollë;
- Sigurojë që raportimi të mos jetë një akt frikësues, por një veprim guximtar dhe i drejtë për mbrojtjen e vetes dhe të tjerëve.

Udhëzuesi përdor një gjuhë të thjeshtë, ilustrime, dhe shembuj nga jeta e përditshme, në mënyrë që të jetë i lehtë për t'u kuptuar nga grupmosha të ndryshme.

CILI LIGJ TË MBRON NGA DHUNA?

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të rriten në një vend të sigurt, ku ndihen të mbrojtur, të dashur dhe të respektuar. Askush nuk ka të drejtë të të lëndojë, të të frikësojë apo të të trajtojë keq, as në shtëpi, as në shkollë, e as në ndonjë vend tjetër.

Në Kosovë, ekziston një ligj i veçantë që mbron fëmijët, ai quhet **Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës**, dhe ka për qëllim të ju mbrojë nga të gjitha format e dhunës, të cilat mund të ju pengojnë juve të rriteni shëndetshëm, të sigurtë, të mësoni, të trajtoheni në mënyrë të barabartë dhe të realizoni ëndrrat tuaja.

Mos Harro:

Ky ligj e detyron shtetin dhe të rriturit rreth teje që të kujdesen dhe të ju mbrojnë juve, pa dallim, duke u bazuar në interesin tuaj më të mirë.

PARANDALIMI I DHUNËS

Për të siguruar që të drejtat e tua të respektohen edhe në shkollë, është krijuar një **Politike për Mbrojtjen e Fëmijëve në Shkollë**¹. Kjo politikë ndihmon që çdo fëmijë, si ti, të ndihet i sigurt, i respektuar dhe i dëgjuar. Ja disa nga gjërat që thotë:

¹ <https://masht.rks-gov.net/politika-per-mbrojtjen-e-femijeve-ne-institucionalet-e-arsimit-parauniversitar/>

Në çdo shkollë duhet të ketë një person të caktuar për mbrojtjen e fëmijëve. Ky person quhet “Koordinator për Mbrojtjen e Fëmijëve” dhe është aty që të të dëgjojë, të të ndihmojë dhe të veprojë nëse ti apo ndonjë shok apo shoqe ndiheni në rrezik.

Mësuesit dhe punonjësit e shkollës duhet të dinë si të parandalojnë dhe ndalojnë dhunën. Ata trajnohen për të njohur shenjat dhe për të ndërhyrë kur është e nevojshme.

Fëmijët duhet të kenë mundësi të flasin dhe të përfshihen në vendime që kanë të bëjnë me ta. Mendimi yt ka vlerë.

Politika mbron të gjithë fëmijët, pavarësisht nëse janë vajza apo djem, dhe ndihmon për të kuptuar që ndonjëherë vajzat dhe djemtë përballen me sfida të ndryshme.

Fëmijët që kanë aftësi të kufizuara, që i përkasin komuniteteve të ndryshme apo që përballen me vështirësi, kanë të drejtë të marrin mbështetje të veçantë.

Kjo do të thotë se nëse ndonjëherë ndihesh i/e frikësuar, i/e lënduar apo i/e pasigurt në shkollë, ti ke të drejtë të flasësh dhe të kërkosht ndihmë, dhe shkolla ka detyrë të të mbrojë.

Ligji i ndihmon të rriturit të mësojnë mënyra të mira për të të edukuar, pa bërë titur apo pa përdorur dhunë. Kjo është një mënyrë e qetë dhe më e mirë për të zgjidhur problemet dhe për të jetuar më mirë me njëri-tjetrin.

CILAT JANË TË DREJTAT E TUA NË SHKOLLË?

Si nxënës/e, ti ke shumë të drejta që të ndihmojnë të ndihesh mirë, i/e sigurt dhe i/e respektuar në shkollë. Këto të drejta nuk janë të përkohshme, ato janë për të gjithë dhe duhet të respektohen gjithmonë!

Më poshtë janë disa nga të drejtat e tua në shkollë:

- **Ti ke të drejtë të ndihesh i/e sigurt**

Askush nuk duhet të të godasë, të të fyejë apo të të bëjë të ndihesh keq. Shkolla duhet të jetë një vend ku ti ndihesh i/e qetë, i/e mbrojtur dhe i/e mirëpritur.

- **Ti ke të drejtë të flasësh dhe shprehësh mendimet**

Ti mund të shprehësh mendimet, idetë dhe ndjenjat e tua, pa u tallur apo ndëshkuar. Nëse sheh ose përjeton diçka të padrejtë, ke të drejtë të flasësh për të.

- **Ke të drejtë të të dëgjojnë**

Kur flet për një problem, duhet të të dëgjojnë me vëmendje dhe seriozitet. Zëri yt ka vlerë dhe ndihmon për të bërë shkollën më të mirë.

- **Ke të drejtë të të trajtojnë me respekt**

Pavarësisht nëse je vajzë apo djalë, çfarë ngjyre të lekurës ki, çfarë besimi apo kombësie i përket, ti duhet të trajtohesh me dinjitet dhe barazi.

- **Ke të drejtë të marrësh pjesë në vendime**

Në shkollë, sidomos për çështje që të prekin si nxënës, duhet të të pyesin edhe ty. Ti mund të marrësh pjesë në këshillin e nxënësve si dhe Asam-

blenë Komunale të Fëmijëve në qytetin tënd dhe të japësh mendimin tënd.

- **Ke të drejtë të mësosh në paqe**

Askush nuk duhet të të pengojë të mësosh. Ke të drejtë të kesh një klasë pa zhurmë, pa dhunë dhe me mbështetje nga arsimtarët dhe të tjerë.

- **Ke të drejtë të kërlesh ndihmë**

Nëse diçka nuk është në rregull, ke të drejtë të kërlesh ndihmë nga një arsimtarë, psikolog/e, prind ose një i rritur tjetër i besuar. **Kjo nuk është “ankesë” – është një e drejtë!**

KUSH TË MBRON NËSE PËRJETON DHUNË BRENDË DHE JASHTË SHKOLLËS?

Në Shkollë

Nëse brenda apo jashtë shkollës ndodh dhunë ty apo fëmijëve të tjerë, atëherë, stafi i shkolles, prindërit, ose personat e tjerë të rritur përgjegjës duhet të veprojnë menjëherë. Ata nuk do të merren vetëm vetë me situatën, por do të njoftojnë edhe të tjerë që mund të ndihmojnë, si p.sh. psikologun, punonjës in social apo institucione të jashtme si policia, në varësi të asaj që ka ndodhur.

Ky grup i personave janë për të të mbrojtur nga çdo formë e dhunës gjatë gjithë kohës:

- Drejtori i shkollës – personi që kujdeset që gjithçka në shkollë të shkojë mirë.
- Këshilli i Prindërve – prindërit që ndihmojnë dhe bashkëpunojnë me shkollën për të bërë shkollën më të mirë.

- Këshilli i Nxënësve – nxënësit që flasin në emër të gjithë nxënësve dhe ndihmojnë me aktivitete.
- Pedagogu – mësuesi që ndihmon nxënësit të mësojnë dhe të rriten sa më mirë.
- Psikologu – personi që ndihmon kur nxënësit ndihen të trishtuar, pasigurtë ose kanë ndonjë problem që kanë nevojë ta flasin.
- Ekipi për ndërmjetësim i bashkëmoshatarëve– grupi që ndihmon nxënësit të zgjidhin shpejt dhe në mënyrë të mirë problemet mes tyre.

Kutitë e ankesave/sugjerimeve: Brenda shkollës janë të vendosura kutitë e sugjerimeve/ankesave. Nëse nuk ndihesh rehat ose i/e sigurtë të bisedosh me dikë drejtpërsëdrejti atëherë ti mund të përdorësh këto kutitë brenda shkollës.

INSTITUCIONET TJERA

Nëse vazhdon të ndihesh i/e frikësuar, rrezikuar apo i/e lënduar, **ke të drejtë të kërkohësh ndihmë edhe jashtë shkollës pa marrë parasyh rrethanat.**

Ka shumë institucione dhe përsona që janë këtu për ty:

■ Policia e Kosovës

Policia është aty për të të mbrojtur ty, familjen tënde dhe njerëzit e komunitetit. Ata do të të dëgjojnë për atë që ka ndodhur dhe do të punojnë me të rriturit për të të ndihmuar.

Numri i telefonit: 192 – mund t'i telefonosh falas në çdo kohë!

■ **Qendra për Punë Sociale**

Këto qendra ndihmojnë fëmijët dhe të rriturit që kanë nevojë për mbrojtje apo përkujdesje. Punonjësit social janë të rritur të trajnuar që dëgjojnë, ndihmojnë dhe kujdesen për mirëqenien tënde.

■ **Këshilli për të Drejtat e Fëmijës (në nivel shtetëror)**

Ky grup përbëhet nga zyrtarë të shtetit që kujdesen që të drejtat e fëmijëve të respektohen kudo, në familje, shkollë, spital, dhe komunitet.

■ **Ekipi për të Drejtat e Fëmijëve (në komunën tënde)**

Në komunën tënde ka një ekip që mbledhet disa herë në vit për të parë nëse fëmijët janë të sigurt dhe nëse institucionet po bëjnë punën siç duhet.

■ **Asambletë Komunale të Fëmijëve**

Në komuna, edhe vetë fëmijët marrin pjesë në Asambletë e Fëmijëve, ku flasin për nevojat dhe të drejtat e tyre. Edhe kjo është një mënyrë që zëri yt të dëgjohet!

■ **Drejtoria Komunale e Arsimit**

Kjo është zyra që kujdeset për të gjitha shkollat në komunën ku jeton ti. Ata sigurohen që shkollat të jenë vende të sigurta dhe që fëmijët të mësojnë siç duhet.

■ **Zyrtari për të Drejtat e Fëmijës në komunën tënde**

Ky është një person i posaçëm që punon për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve, si në shkollë, ashtu edhe në komunitet. Nëse një e drejtë e jotja nuk respektohet, ky person është aty për të ndihmuar.

■ **Avokati i Popullit**

Nëse mendon se raportimi yt nuk është trajtuar me seriozitet apo nuk është vendosur me kohë nga drejtoria, policia, qendra për punë sociale, ministria etj. atëherë ti mund të drejtohesh për tek Institucioni i Avokatit të Popullit. Kjo është një zyrë që mbron të drejtat e të gjithë njerëzve, përfshirë edhe ty si fëmijë. Mund të kontaktosh falas në **numrin e telefonit: 0800 15555** ose shkruaj në email: info.oik@oik-rks.org.

■ **Organizatat joqeveritare**

Ka shumë organizata që punojnë për të ndihmuar fëmijët, për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe për të ndaluar dhunën në shkolla e komunitet. Këto organizata shpesh bëjnë aktivitete, trajnime dhe mbështesin fëmijët që kanë nevojë.

ÇKA NËSE DHUNA NDODH NË SHTËPI APO MJEDISE JASHTË SHKOLLËS?

Kurdo që ndiheni të rrezikuar dhe të pasigurtë, ju mund të raportoni tek të rriturit e besuar, Policia e Kosovës dhe Qenda për Punë Sociale në komunën tuaj. Ata janë të gatshëm për ju në çdo kohë dhe kudo që ndodheni.

Mos harro:

Ti ke të drejtë të kërkohësh ndihmë dhe gjithmonë do të ketë dikë që të dëgjon dhe të mbrohet në çdo kohë dhe vend.

SI TË IDENTIFIKOSH DHUNËN?

Është shumë e rëndësishme që të njohim dhunën dhe të dimë si ta raportojmë atë për t'u mbrojtur dhe për të krijuar një mjedis të sigurt për vetën dhe të tjerët. Më poshtë janë disa nga format më të shpeshta të dhunës:

Dhuna fizike - nënkupton çdo formë të abuzimit fizik duke përfshirë këtu goditje me dorë, këmbë apo me ndonjë gjesend.

- **Shembuj:** kur dikush (nxënës apo i rritur) të shtyn, godet, të pickon, ose të kap fort për të të lënduar, të shtrëngon fort në fytyrë, duar apo të shkakton dhimbje.

Dhuna verbale - nënkupton përdorimin e fjalëve që lëndojnë.

Mos harro:

Fjalët mund të lëndojnë po aq sa veprimet! Nëse dikush të flet keq apo të bën të ndihesh keq me fjalë, është dhunë dhe duhet ti tregosh dikujt të besuar.

- **Shembuj:** kur dikush (nxënës apo i rritur) të bërtet ose të flet me zë të lartë dhe me nerva, të fyen apo të tall, bën zhurma me gojë që të tallin ose fyejnë, të kërcënon ose përpiket të të frikësojë, të turpëron para të tjerëve ose përdor fjalë të këqija dhe të nënçmon.

Mos Harro:

Nëse dikush të dërgon mesazhe të këqija, shpërndan fotot e tua pa leje, të kërcënon ose të ofendon online, kjo është dhunë dhe mund ta raportosh menjëherë.

Ti ke të drejtë të jesh i/e sigurt edhe në internet!

Dhuna digjitale - nënkupton çfarëdo forme të përdorimit të teknologjise (nxënës apo i rritur) si telefoni dhe interneti me qëllim të lëndimit, kërcënimit, shqetësimit apo çfarëdo lloji tjetër të ofendimit.

- **Shembuj:** mund të jetë në formë të komenteve, mesazheve, fotografive, thirrjeve, dërgon mesazhe fyese ose kërcënuese, shpërndan foto apo video pa lejen tënde, të turpëron apo përqesh në rrjete sociale, të telefonon për të të frikësuar apo shqetësuar.

Dhuna emocionale - nënkupton sjelljet nga (nxënës apo të rritur) të cilat të shkaktojnë dëm në shëndetin dhe zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, dhe social.

- **Shembuj:** kur dikush (nxënës apo i rritur) të kontrollojnë tepër ose nuk të lejon të lëvizësh lirisht, të tallin, të fajësojnë ose të përqeshin vazhdimisht, të kërcënojnë ose përpiqen të të trembin, të diskriminojnë apo nuk të trajtojnë njësoj me të tjerët, të bëjnë të ndihesh sikur nuk je i/e rëndësishëm/e ose sikur nuk vlen.

Dhuna Psikologjike - është kur dikush (nxënës apo i rritur) të lëndon emocionalisht dhe shpirtërisht, dhe të bën të ndihesh keq me veten.

- **Shembuj:** kur të përjashtojnë nga grupi apo loja me qëllim, të injorojnë ose nuk të flasin, të bëjnë të ndihesh fajtor apo i/e pavlerë, të detyrojnë të bësh diçka që nuk do, të kërcënojnë ose të frikësojnë, të ofendojnë vazhdimisht ose të tallin.

Mos harro:

Dhuna psikologjike shpeshherë nuk shihet lehtë ose është e vështirë të shpjegohet me fjalë por lëndon shumë dhe përcillet nga format e tjera të dhunës si bullizmi, dhuna digjitale, dhuna seksuale etj. është e rëndësishme që të raportohet si të gjitha format e tjera të dhunës!

Bullizëm/Ngacmim (në shkollë ose online) - është një formë dhune kur dikush të lëndon me qëllim, vazhdimisht dhe e bën të ndihesh keq. Mund të ndodhë në shkollë ose online (në internet).

- **Shembuj:** kur të tallin, të ofendojnë apo të përqeshin për pamjen, emrin apo ndonjë veçori tjetër, të përjashtojnë nga grupi apo loja me qëllim, të kërcënojnë, godasin ose shtyjnë, ose të shpërndajnë foto apo mesazhe për të të turpëruar në rrjete sociale.

Në një raport nga Save the Children (2024)² fëmijët u pyeten **“Në rastet kur ka ngacmim, si adresohet në shkollën tuaj?”**. Si rezultat, **77%** i fëmijëve raportuan se e adresonin nëpërmjet mësuesit të klasës, **41%** nëpërmjet drejtorit dhe **40%** nëpërmjet prindërve të tyre.

Dhuna në baza gjinore - kur dikush të keqtrajton vetëm sepse je vajzë apo djalë, ose për shkak të mënyrës se si shpreh identitetin tënd gjinor (psh. veshja, stili i flokëve etj) .

- **Shembuj:** Kur një vajzë nuk lejohet të marrë pjesë në lojëra ose përqeshet sepse “vajzat nuk dinë të luajnë mirë”, ose kur një djalë tallët nga shokët sepse qan dhe dikush i thotë “mos u sill si vajzë”, ose një nxënës keqtrajtohet sepse nuk vishet apo sillet ndryshe dhe jo sipas pritshmërive të të tjerëve për gjininë e tij/saj.

Dhuna Seksuale - Dhuna seksuale ndodh kur dikush (nxënës apo i rritur) sillet në mënyrë të papërshtatshme me trupin apo ndjenjat e tua apo di kujt tjetër.

- **Shembuj:** Shikime të pakëndshme, komente me fjalë ose gjeste, prekje, ledhatime, ngacmim, zhveshja, prekja në pjesët intime të trupit, shfaqja apo dergimi i fotove apo videove pornografike, ekspozimi dhe tërheqja e vëmendjes me anë të pjesëve intime. Kjo dhunë mund të ndodhë nga bashkëmoshataret dhe të rriturit.

Forma të tjera të dhunës - Eksploatimi ndodh kur të detyrojnë të bësh punë pa dëshirë, kur të detyrojnë të përdorësh substanca narkotike (si droga, alkooli). Forma të tjera të dhunës janë racizmi, përjashtim dhe diskriminim për shkak të pamjes, situatës ekonomike, kombësisë ose gjinisë.

² <https://resourcecentre.savethechildren.net/pdf/Young-Voices-2024.pdf>

PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË RAPORTOSH?

Mos harro:

Raportimi është një mënyrë për të ndaluar dhunën dhe për t'i treguar të rriturve që ka një problem që duhet zgjidhur. Askush nuk ka të drejtë të të lëndojë, frikësojë apo të të bëjë të ndihesh keq.

Kur raporton, ndihmon veten dhe të tjerët. Askush nuk ka të drejtë të të lëndojë. Është gjithmonë në rregull të flasësh. Kur ti raporton një situatë të dhunës apo bullizmit, ti po ndihmon jo vetëm veten, por edhe shokët dhe shoqet e tua që të jenë më të sigurtë.

Është gjithmonë e drejta jote të flasësh dhe të kërkes ndihmë – nuk duhet të kesh frikë apo turp.

Çfarë Ndodh Pasi të Raportoje?

Kur ti raporton një problem, një i rritur i besuar, si psh. prindi, arsimtari, psikologu, drejtori i shkollës, policia, ose qendra për punë sociale në komunën tënde, do të të dëgjojnë me kujdes dhe do të përpiqen të të ndihmojë.

Gjithashtu, ata/ato do të respektojnë raportimin tënd dhe do ta mbajnë atë të sigurt, që askush tjetër të mos të shqetësojë për shkak të raportimit tënd.

Ata poashtu duhet të përkujdesen që ti të ndihesh i/e sigurtë pas raportimit dhe të ofrojnë mbrojtje gjatë tërë kohës.

Si mund të ndihmosh më tutje?

a. Angazhohu në këshillin e shkollës

Një mënyrë e mirë për të ndihmuar është angazhimi në këshillin e shkollës. Këshilli i nxënësve është një grup ku mund të flasësh për problemet që hasin nxënësit, të propozojë ide dhe të ndihmosh në organizimin e aktiviteteve që nxisin respektin dhe mirëqenien në shkollë. Duke qenë pjesë e këshillit, ti mund të ndihmosh që zëri yt dhe i shokëve të dëgjohet nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollës.

b. Respekto Barazinë Gjinore

Një pjesë shumë e rëndësishme e krijimit të një shkolle të sigurt dhe të drejtë është të respektojmë barazinë gjinore. Kjo do të thotë që vajzat dhe djemtë të trajtohen njësoj, me respekt dhe mundësi të barabarta për të marrë pjesë në aktivitete, për të shprehur mendimet e tyre dhe për t'u ndjerë të sigurt.

Ti mund të ndihmosh duke u përpjekur që:

- të mos lejojsh që dikush të tallet apo të përjashtojë një person vetëm sepse është vajzë ose djalë ose nga mënyra se si vishet ose shpreh veten;
- të inkurajosh shokët dhe shoqet që të respektojnë zgjedhjet dhe mënyrën se si secili shpreh veten, pavarësisht nëse ato janë vajza apo djem;
- të kërkosh që në aktivitetet e shkollës të ketë mundësi të barabarta për të gjithë, si në sport, art, diskutime dhe lojëra;
- të flasësh kundër stereotipeve të dëmshme gjinore, për shembull kur dikush thotë se “vajzat nuk dinë të luajnë futboll” ose “djemtë nuk duhet të qajnë”.

c. Merr pjesë në aktivitetet e organizuara nga shkolla

Një tjetër mënyrë e rëndësishme është pjesëmarrja në aktivitetet e organizuara nga shkolla, veçanërisht ato që lidhen me datat e rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare. Për shembull:

- **1 Qershori, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve** - në këtë datë zhvillohen aktivitete për t'i kujtuar të drejtat e fëmijëve dhe për të festuar së bashku;
- **Muaji për Anti-Trafikim** - gjatë kësaj dite flitet për rreziqet dhe mënyrat si mund të mbrohem nga trafikimi i njerëzve;
- **16 Ditët e Aktivizimit** - në këto ditë organizohen aktivitete për të edukuar dhe luftuar dhunën në baza gjinore.

d. Bisedoje me shokët dhe shoqët e tua!

Është e rëndësishme që **të ndash këto informacione me shokët dhe shoqet e tua**. Ti mund të ndihmosh duke biseduar me ta/to për rëndësinë e raportimit, duke mbështetur ata që të raportojnë nëse kanë probleme dhe duke nxitë që secili të ndihet i/e sigurtë.

SHTOJCË.

Aktivitet individual

Plani im i Sigurisë në shkollë dhe jashtë saj

(Plotëso të dhënat më poshtë sipas nevojave tua)

Në rast se më ndodhë mua apo dikujt që njoh diçka në shkollë apo jashtë shkollës, kujt mund ti tregoj?

Personat që unë kam besim (plotëso):

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

Brenda shkollës mund të flas me:

1. Prindin
2. Mësuesin ose mësuesen/Arsimtarin/en
3. Drejtorin e shkollës
4. Psikologun e shkollës
5. Këshillin e nxënësve
6. Kutia e ankesave (sugjerimeve)

Ku mund të raportoj në rast se vazhdoj të mos ndihem i/e sigurtë?

7. Policia (thirr në numrin falas 192 ose afrohem te një polic apo police)
8. Qendra për punë sociale (në komunën time)
9. Avokati i popullit (numri kontaktues 080015555)

